

URDHËR
Nr.5949/5, datë 29.12.2011

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E
KOMISIONIT DISIPLINOR TË PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË” DHE
PËRCAKTIMIN E MASËS SË SHPËRBLIMIT TË ANËTARËVE TË TIJ**

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës, të ligjit nr.9000, datë 30.1.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, të nenit 7 të ligjit nr.8678, datë 14.5.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, të ndryshuar, të nenit 51 të ligjit nr. 10031, datë 11.12.2008 “Për shërbimin përmbarimor gjyqësor privat”,

URDHËROJ:

1. Miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit Disiplinor të Përmbaruesve Gjyqësorë Privatë”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij urdhri dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Masa e shpërblimit të anëtarëve të Komisionit Disiplinor është 10 000 (dhjetë mijë) lekë për çdo mbledhje. Masa e shpërblimit mbulohet nga llogaria e Dhomës Kombëtare të Përmbaruesve Gjyqësorë Privatë.

3. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Ministria e Drejtësisë, Dhoma Kombëtare e Përmbaruesve Gjyqësorë Privatë dhe Dhoma Kombëtare e Avokatëve.

Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I DREJTËSISË
Eduard Halimi